

**Njësia EF1:** Siguro që veprimet tuaja në vendin e punës ndaj zjarrit të bimësisë të zvogëlojnë rreziqet për veten dhe për të tjerët

**Elementi 1.1:** Identifiko dhe vlerëso rrezikshmëritë<sup>1</sup> që ka mundësi të gjenden në vendin e punës

**Elementi 1.2:** Zvogëlo rreziqet që ka të ngjarë të gjenden në vendin e punës

**Elementi 1.3:** Përgjigju ndaj emergjencave shëndetësore në vendin e punës

## Rreth kësaj njësie:

Kjo Njësi merret me çështjet e sigurisë me të cilat përballen individët që janë të përfshirë në ndihmën për menaxhimin e zjarreve të bimësisë në zonat rurale, qoftë në shuarjen e zjarrit, qoftë në operacionet e djegies me plan.

Është zhvilluar në mënyrë që të mund të aplikohet në çdo zonë të bimësisë: pyll, shkurre, bar ose ngjajshëm.

Kjo Njësi synon ata që punojnë në shërbimet zjarrfikëse, bujqësi, pylltari, menaxhimin e kafshëve për gjueti, aktivitetet e konservimit, menaxhimin e territorit dhe rekreacionit dhe që kanë rol në ndihmën me menaxhimin e zjarreve të bimësisë, qoftë në kohë të plotë, me kohë të pjesshme ose vullnetare.

## Për të arritur këtë Njësi duhet të tregoni se jeni në gjendje të:

- Vlerësoni rrezikshmëritë në vendin e punës të zjarrit të bimësisë
- Ndiqni procedurat organizative ndaj zjarrit

<sup>1</sup> **Shënim:** Në gjuhën shqipe, si dhe në shumë gjuhë tjera, nuk egziston term adekuat për termin “hazard” dhe dallim të tij ndaj termit “risk”. Pasi dallimi është evident dhe i nevojshëm për këtë material edukimi, por në përgjithësi për praktikantët në fushën e zjarreve, në konsulencë me ekspertet e fushës të përkthimit, por edhe profesore nga GFMC dhe RFMC, u vendos që keto 2 terme të mbahen në formën si vijon “en. hazard = shq. rrezikshmëri” dhe “en. risk=shq. rrezik”.

Për detaje të mëtejshme, referohuni në faqen 3 të dokumentit “Njësia EF1: Trajnim: Siguro që veprimet tuaja në vendin e punës të zjarrit të bimësisë të zvogëlojnë rreziqet për veten dhe të tjerët.”

- Veproni në mënyrë të sigurtë në vendin e zjarrit
- Mbështetni të tjerët që veprojnë në vendin e zjarrit
- Reagoni në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat organizative, legjislative dhe mjedisore, ndaj një incidenti zjarri.

<b>Fjalët dhe frazat kyçe:</b>	Që të kuptoni plotësisht përmbajtjen e njësisë, dhe aktivitetet që ajo përshkruan, është e rëndësishme që të jeni në gjendje të kuptoni termat e përdorur brenda njësisë. Përkufizimet në pjesën e pasme të kësaj njësie duhet t'ju ndihmojnë me këtë.
Linja e kontrollit	Të gjitha pengesat e ndërtuara ose natyrore dhe kufinj zjarri të trajtuar që përdoren për të kontrolluar një zjarr.
Sulm i drejtpërdrejtë	Aktivitetet e kontrollit të zjarrit të aplikuara direkt në zjarr
Vlerësimi dinamik i rrezikut	Procesi i vazhdueshëm i identifikimit aktiv të rrezikshmërive, vlerësimi të rreziqeve dhe marrjes së masave për eliminimin ose reduktimin e rrezikut. Të gjitha këta në rrethanat që ndryshojnë me shpejtësi gjatë një incidenti
Sjellje zjarri	Mënyra se si zjarri reagon ndaj variablave të karburantit, motit dhe topografisë të përshkruara në aspektin e intensitetit të zjarrit dhe shkallës së përhapjes.
Rrezikshmëri zjarri	Ekspozimi i mundshëm i njerëzve apo pronave ndaj rrezikut nga sjellja e zjarrit
Intensiteti i zjarrit	Pulsi ose shkalla e lirim të energjisë, që udhëton larg nga zjarri, shpesh e lidhur me gjatësinë e flakës
Rreziku i zjarrit	Mundësia që një zjarr të fillojë
Zyra e Mbështetjes ndaj Zjarrit	Zyra e Qarkut Pyjor, Zyra e Pronës, ose zyra e kompanisë ku ndihmohet për përpjekjet për kontroll të zjarrit
Hangar kundërzjarri	Vendi ku ruhen pajisjet për kontroll të zjarrit
Lloji i zjarrit	Zjarri në tokë, zjarri sipërfaqësor ose zjarri i kurorës, lloji më i zakonshëm është zjarri sipërfaqësor
Moti i zjarrit	Kushtet klimatike të parashikuara që mbulojnë periudhën e djegies, veçanërisht erën, temperaturën e ajrit dhe lagështinë relative,
Gjatësia e flakës	Distanca midis majës së flakës dhe mesit të bazës së flakës (në përgjithësi sipërfaqja e tokës), tregues ky i intensitetit të zjarrit
Krah zjarri	Anët e zjarrit
Sulm nga krahu	Strategjia më e zakonshme e sulmit të drejtpërdrejtë, që fillon aktivitetin e kontrollit nga një pikë ankorimi, pastaj përparon përgjatë krahëve ndaj qendrës
Karburantet	Lloji, sasia, rregullimi, shpërndarja dhe përmbajtja e lagështisë së bimësisë. Mund të jenë: lëndë djegëse tokësore (rrënjë), sipërfaqe (mbeturina bimore, bar, shkurre) ose lëndë djegëse në ajër (pemë)
Rrezikshmëri	Çdo gjë që mund të shkaktojë dëm, si automjetet, kimikatet, elektriciteti, pajisjet, puna me shkallë, etj
Balli	Pjesa e përparme e zjarrit që tregon shkallën më të madhe të përhapjes

Thembra	Pjesa e pasme e zjarrit pranë lokacionit origjinës të zjarrit
Pikë e nxehtë	Një zonë e vogël me djegie të madhe, të shndritshme që ndodhet në perimetrin e zjarrit ose brenda saj; një term i përdorur zakonisht gjatë fazës së pastrimit të një zjarri
Sulm indirekt	Aktiviteti i kontrollit të zjarrit larg skajit të zjarrit p.sh. djegia pas shpine
LACES	<i>Vëzhgimet, ndërgjegjësimi, komunikimet, rrugët e arratisjes dhe zonat e sigurisë</i>
Origjina	Vendi ku fillon zjarri
Shkalla e përhapjes	Shpejtësi se sa po zgjerohet zjarri në krye të zjarrit
Rrezik	Shansi, i lartë ose i ulët, që dikush mund të dëmtohet nga një rrezikshmëri, së bashku me një tregues se sa i rëndë mund të jetë dëmi.
Topografia	Forma e tokës, veçanërisht pjerrësia dhe aspekti
Zjarr në mjedis të hapura	Zjarr që nuk po kontrollohet

### **Elementi 1.1: Identifikoni dhe vlerësoni rrezikshmëritë që ka të ngjarë të gjenden në vendin e punës**

#### **Çfarë duhet të jeni në gjendje të bëni:**

- 1 Emëroni dhe lokalizoni saktë personin/at përgjegjës për sigurinë në vendin e punës
- 2 Identifikoni rrezikshmëritë që mund të gjenden në çdo pjesë të rolit tuaj të punës që mund t'ju dëmtojnë ju ose persona të tjerë
- 3 Vlerësoni dhe jepni shkallëzim rrezikshmërive që mund të gjenden në vendin tuaj të punës
- 4 Raportoni çdo rrezikshmëri që paraqet një rrezik të lartë për kolegët, mbikëqyrësit dhe personin/at përgjegjës për sigurinë
- 5 Merruni me çdo rrezikshmëri që paraqet një rrezik të ulët në përputhje me politikën e organizatave tuaja, kërkesat ligjore dhe mjedisore
- 6 Vlerësoni mjedisin e zjarrit logjikisht dhe parashikoni sjelljen lokale të zjarrit
- 7 Aplikoni teknikat dinamike të vlerësimit të rrezikut

#### **Ky element mbulon:**

Identifikimi i rrezikshmërive që mund të përfshijnë:

- (i) Mjedisin natyror duke përfshirë topografinë, bimët dhe kafshët
- (ii) Mjedisin e zjarrit dhe sjelljen e zjarrit

- (iii) Rrezikshmëritë që nuk lidhen me zjarrin, por me karburantet dhe motin, pajisjet, automjetet dhe avionët

**Elementi 1.1  
vazhdim:**

**Identifikoni dhe vlerësoni rreziqet që ka të ngjarë të gjenden në vendin e punës**

- (iv) Operacionet
- (v) Shërbime mbi/nëntokësore

Çmoni dhe vlerësoni rreziqet që rezultojnë nga: -

- (i) Kushtet mjedisore
- (ii) Përdorimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve ose makinerive
- (iii) Sjellje ose praktika pune të pasigurta
- (iv) Përdorimi i materialeve dhe substancave të tjera
- (v) Derdhje aksidentale

**Çfarë duhet të dini dhe të kuptoni:**

- a. Gjeografia bazë dhe ekologjia e zonës
- b. Trekëndëshi i zjarrit dhe metodat e shuarjes duke përdorur një shumëllojshmëri të mjeteve për shuarjen e zjarrit të bimësisë
- c. Rrezikshmëritë e paraqitura nga mekanizmat e transferimit të nxehtësisë, llojet e djegies dhe llojet e zjarrit.
- d. Efekti i mjedisit të zjarrit në sjelljen e zjarrit dhe sigurinë personale
- e. Përdorimi i gjatësisë së tymit dhe flakës si një udhëzues për zbatimin e sigurt të mjeteve, taktikave dhe strategjive
- f. Mjetet, teknikat, taktikat dhe strategjitë e përdorura për të kontrolluar zjarret e bimësisë
- g. Si të punoni në mënyrë të sigurt në afërsi të: sharra me zinxhir, automjete, traktorë, buldozerë, helikopterë dhe avionë.
- h. Si të punoni nën udhëzim, si pjesë e një ekipi, me një shumëllojshmëri mjetesh, teknikash dhe strategjish gjatë një sulmi të kombinuar

**Çfarë duhet të jeni në gjendje të bëni:**

- 1 Kryen veprime të sigurt sipas udhëzimeve, në përputhje me politikën dhe procedurat organizative, prodhuesit dhe kërkesat ligjore
- 2 Përparoni objektivat tuaja, në mënyrë të sigurt dhe brenda procedurave organizative
- 3 Ndrejini rreziqet e sigurisë dhe shëndetit brenda aftësive tuaja dhe fushëveprimit të përgjegjësive tuaja të punës
- 4 Kaloni çdo sugjerim për reduktimin e rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin brenda rolit tuaj të punës tek personat përgjegjës
- 5 Monitoroni në mënyrë proaktive efektet e aktivitetit në shëndetin, hidratimin dhe lodhjen e njerëzve që ju rrethojnë dhe vetes.
- 6 Identifikoni rolin e vëzhguesve, jini të vetëdijshëm për situatën në çdo kohë dhe përdorni rrugët e arratisjes dhe zonat e sigurisë sipas nevojës
- 7 Përgatitni, mirëmbani dhe vishni në mënyrë korrekte pajisjet mbrojtëse personale

**Ky element mbulon:**

Masat mbrojtëse në kuadrin e:

**A Çështjet personale:**

- (i) Çështjet mjekësore paraprake
- (ii) Gjendja fizike
- (iii) Lodhja
- (iv) Stresi
- (v) Stresi nga nxehtësia, rraskapitja ndaj nxehtësisë ose goditja e nxehtësisë
- (vi) Hipotermia
- (vii) Djegie dielli / djegie ere

**B Pajisje mbrojtëse personale (PMP):**

- (i) Helmeta/Mburoje e fytyrës/Syze
- (ii) Veshje rezistente ndaj zjarrit

- (iii) Doreza
- (iv) Çizme rezistente ndaj nxehtësisë
- (v) Uji i pijshëm
- (vi) Mbrojtja e dëgjimit

C Sjellja e zjarrit:

- (i) Nxehtësi rrezatuese dhe ajër super i nxehur
- (ii) Tym dhe pluhur
- (iii) Ndryshime të shpejta në drejtimin ose shpejtësinë e zjarrit
- (iv) Ndryshime të shpejta në gjatësinë e flakës dhe intensitetin e zjarrit

D Pajisjet:

- (i) Mbrojtja ndaj zhurmës dhe e dëgjimit
- (ii) Pjesë lëvizëse
- (iii) Makina lëvizëse
- (iv) Rrezikshmëri kimikatesh, lëndë djegëse dhe substanca të tjera

E Politikat e vendit të punës:

- (i) Përdorimi i metodave dhe pajisjeve të sigurt të punës
- (ii) Përdorimi i sigurt i substancave me rrezikshmëri
- (iii) Pirja e duhanit, ngrënia, pirja dhe drogat
- (iv) Termine pushimi
- (v) Procedurat e emergjencës

**Çfarë duhet të dini dhe të kuptoni:**

- a. Kuptoni rrezikshmëritë në vendin e punës të zjarrit të bimësisë dhe mënyrat e eliminimit dhe minimizimit të efekteve të tyre
- b. Kuptoni rëndësinë e shëndetit fizik

- c. Përparësia e zjarrfikësve dhe sigurisë publike, së bashku me vlerat dhe pasuritë që po përpiqeni të mbron
- d. Roli i pikave vëzhguese, rëndësia e të qenit i vetëdijshëm për situatën dhe të jesh në gjendje të komunikosh me anëtarët e ekipit dhe mbikëqyrësit tuaj në çdo kohë. Vetëdijar se ku janë rrugët tuaja të arratisjes, si dhe kur t'i përdorni ato dhe sa kohë do të duhet për të arritur në zonat tuaja të caktuara të sigurisë (LACES)
- e. Efikasiteti dhe siguria e mjeteve dhe teknikave të ndryshme të kontrollit të zjarrit të aplikuara në një sërë situatash

### **Elementi 1.3: Përgjigje ndaj emergjencave shëndetësore në vendin e punës**

#### **Çfarë duhet të jeni në gjendje të bëni:**

- 1 Thirrni menjëherë ndihmë për çdo emergjencë shëndetësore dhe nisni veprime të përshtatshme ndaj gjendjes dhe situatës
- 2 Jepni ndihmë me kujdes të vazhdueshëm sipas nevojës
- 3 Sigurojini individit urgjencën shëndetësore me mbështetje të përshtatshme verbale
- 4 Bëjeni vendngjarjen sa më private dhe të sigurt që të jetë e mundur sapo ndërhyrja të jetë marrë përsipër nga një person i përshtatshëm
- 5 Ofroni mbështetje për të gjithë të tjerët të përfshirë në incident sapo të kalojë ndonjë rrezik fillestar
- 6 Mbani shënime të sakta, të lexueshme dhe të plota

#### **Ky element mbulon:**

- A Situatat ku:
  - (i) Nuk ka qasje të menjëhershme ndaj një personi kompetent për t'u marrë me situatën
  - (ii) Ka qasje të menjëhershme në një personi kompetent për t'u marrë me situatën
  - (iii) Personi me urgjencë shëndetësore është në një vend të rrezikshëm

#### **Çfarë duhet të dini dhe të kuptoni:**

- a. Veprimin që kërkohet ta ndërmerni për urgjencën shëndetësore në fjalë

- b. Kompetenca juaj në trajtimin e emergjencës shëndetësore
- c. Arsyet e thirrjes për ndihmë menjëherë
- d. Rëndësia e mos kryerjes së veprimeve përtej aftësive tuaja
- e. Arsyet pse veprimet përtej nivelit tuaj të kompetencës mund të rrezikojnë më tej jetën
- f. Mënyra efektive për të siguruar mbështetje për ata që vuajnë nga një urgjencë shëndetësore dhe për t'i mbajtur ato në gjendjen më të mirë të mundshme
- g. Efektet e tronditjes në një emergjencë shëndetësore të individit dhe mënyrat e trajtimit në mënyrë efektive
- h. Lloji i mbështetjes verbale që mund t'i jepet individit që vuan emergjencën shëndetësore
- i. Rreziqet e mundshme për shëndetin e të tjerëve nga një urgjencë
- j. Arsyet për ofrimin e mbështetjes dhe ndihmës për të tjerët e përfshirë në incident dhe si duhet arritur kjo
- k. Kërkesat legjislative përkatëse për plotësimin e regjistrimeve të aksidenteve dhe emergjencave
- l. Vendndodhja dhe përdorimi i pajisjeve të ndihmës së parë sipas politikave dhe procedurave organizative



Ky mohim përgjegjësie administron përdorimin tuaj të kësaj faqe interneti dhe duke përdorur këtë faqe interneti ju gjykohet se e keni pranuar plotësisht këtë mohim. Ju lutem vini re se informacioni në këtë faqe interneti mund të ndryshohet ose të përditësohet pa njoftim. Qendra Globale e Monitorimit të Zjarrit, Shoqata Ndërkombëtare e Shërbimeve të Zjarrit dhe Shpëtimit dhe Iniciativave të Zhvillimit Rural Ltd (së bashku "EuroFire Partners") [dhe host i kësaj faqe interneti] nuk pranojnë asnjë përgjegjësi për, dhe përjashtojnë të gjithë përgjegjësinë (në masën maksimale të lejueshme me ligj) në lidhje me navigimin, përdorimin e informacionit të përmbajtur në këtë faqe interneti, dhe shkarkimin e çdo materiali nga kjo faqe interneti. Informacioni në këtë faqe interneti nuk përbën këshilla ligjore apo profesionale. Informacioni dhe/ose materialet e përfshira në këtë faqe interneti jepen vetëm për qëllime të përgjithshme informacioni dhe nuk përbëjnë informacion apo materiale të cilat duhet të mbështeten për një qëllim të caktuar, duke përfshirë por pa u kufizuar në hyrjen në ndonjë kontratë. EuroFire Partners [dhe host i kësaj faqe interneti] nuk pranojnë asnjë përgjegjësi për plotësinë apo saktësinë e ndonjë informacioni apo deklarate që gjendet në këtë faqe interneti apo për ndonjë humbje apo dëm që mund të vijë nga mbështetja në të njëjtën, nëse ndonjë humbje e tillë është direkte, indirekte apo rrjedhimore. Nuk duhet të mbështetet në përmbajtjen e kësaj faqeje interneti dhe nuk duhet të veproni mbi këtë informacion pa kërkuar këshilla profesionale nga persona të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme në juridiksionin tuaj përkatës. Përjashtime specifike mund të aplikohen përveç këtij mohim përgjegjësie në lidhje me disa përmbajtje ose pjesë të kësaj faqe interneti. Lidhjet me faqet e tjera të internetit nga kjo faqe janë vetëm për informacion dhe EuroFire Partners [dhe host i kësaj faqe interneti] nuk pranojnë asnjë përgjegjësi për qasjen, ose materialet në ndonjë faqe interneti e cila është e lidhur nga ose me këtë faqe interneti dhe nuk miratojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e shprehura brenda tyre. Informacioni i përmbajtur në këtë faqe interneti mund të përfshijë opinione ose pikëpamje të cilat, përveçse kur shprehet posaçërisht ndryshe, nuk janë ato të ndonjë apo të gjithë EuroFire Partners ose ndonjë kompanie shoqëruese apo ndonjë personi në lidhje me të cilin do të kishin përgjegjësi ose përgjegjësi të lidhur. Të gjitha materialet në këtë faqe janë të mbrojtura nga ligjet e të drejtës së autorit dhe pronësisë intelektuale dhe përveç nëse thuhet shprehimisht ose ndryshe është rënë dakord me shkrim, ju mund të aksesoni dhe shkarkoni materialet e vendosura në këtë faqe interneti vetëm për përdorim personal, jo-komercijale, subjekt i pohimit të duhur.

EuroFire Partners nuk garanton që funksionet e disponueshme në këtë faqe interneti do të jenë të pandërprera ose pa gabime, se defektet do të korrigjohen, ose se serveri që e vë në dispozicion këtë faqe interneti është i lirë nga viruset apo gabimet. Ju pranoni se është përgjegjësia juaj të zbatoni procedura të mjaftueshme dhe kontrole të virusit (duke përfshirë anti-virus dhe kontrole të tjera sigurie) për të përmbushur kërkesat tuaja të veçanta për saktësinë e hyrjes dhe daljes së të dhënave. Informacioni dhe përmbajtjet e tjera të këtij kësaj faqe interneti janë projektuar për të respektuar ligjet e Skocisë. Kjo faqe interneti do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Skocisë dhe të gjithë përdoruesit e kësaj faqe interneti i nënshtrohen në mënyrë të parevokueshme juridiksionit të gjykatave skoceze në lidhje me çdo pretendim apo veprim tjetër të lidhur me këtë faqe interneti ose përdorimin e tyre. Nëse ndonjë gjë në këtë faqe interneti është interpretuar si në kundërshtim me ligjet e zbatueshme në çdo vend tjetër, atëherë kjo faqe interneti nuk ka për qëllim të qaset nga persona nga ai vend dhe çdo person që është subjekt i ligjeve të tilla nuk do të ketë të drejtë të përdorë shërbimet tona apo ndonjë informacion të prodhuar në këtë faqe.